# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6938
E premte, 7 korrik 2023
Çmimi 0.40


## Shqipëria i firmos 13 marrëveshjet me Kosovën

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA VIZITUAR KOSOVËN FAQE 3

# KURTI IA MBYLLI DERËN RAMËS



Nuk mbahet mend që prej pasluftës që një kryeministër i Kosovës t'ia ketë mbyllur derën kryeministrit të Shqipërisë, presidentit apo kryeparlamentarit të këtij vendi kur kanë parashtruar kërkesë për vizitë në Prishtinë, pavarësisht qoftë edhe bindjeve politike. Por këtë e ka bërë të enjten kryeministri Albin Kurti, duke mos pranuar takim me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Ky i fundit gjatë turneut të tij në kryeqytetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor, në Prishtinë u prit nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryeparlamentari Glauk Konjufca, ku u theksua nevoja e forcimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve të dy shteteve

## GJERMANIA NDËRPRET BASHKËPUNIMIN ME KOSOVËN NË DISA FUSHA SHKAKU I TENSIONEVE

FAQE 4-5



## HRW: UKRAINA DHE RUSIA TA NDALOJNË PËRDORIMIN E BOMBAVE THËRRMUESE

FAQE 2

## AKTUALE



### ZYRTARI I NATO-s: PRISHTINA DHE BEOGRADI TË NDËRMARRI N PËR SHTENSIONIM F. 5

### BE-JA: SHPALLJA E DY ORGANIZATAVE NË VERI TERRORISTE, HAP I NJËANSHËM F. 7

### KOMUNA E RAHOVECIT FORMON SHTABIN KOMUNAL PËR KORRJE-SHIRJE PËR VITIN 2023 F. 6

## EKONOMI



### GJYKATA E PEJËS MERR VENDIM PËR LIRIMIN E VILAVE TË SEKUESTRUARA NË BREZOVICË F. 8

### NDRYSHIMI I LIGJIT PËR SKEMAT PENSIONALE, REAGON BSPK-ja F. 8

## SPORT



### GJERAJ PENSIONOHET NGA FUTBOLLI NË MOSHËN 39-VJEÇARE F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# HRW: Ukraina dhe Rusia ta ndalojnë përdorimin e bombave thërrmuese

Nju-Jork, 6 korrik - Si forcat ruse ashtu edhe ato ukrainase kanë përdorur municione thërrmuese që kanë vrarë civilë ukrainas, tha organizata Human Rights Watch (HRW) në një raport të publikuar më 6 korrik.
Ky raport i HRW-së vjen në kohën kur Shtetet e Bashkuara po e shqyrtojnë kërkesën e qeverisë ukrainase, e cila po kërkon nga Uashingtoni ta furnizojë me municione të tilla.
HRW u bëri thirrje Rusisë dhe Ukrainës të ndalojnë së përdoruri bombat thërrmuese dhe i bëri thirrje ShBA-së të mos e furnizojë Ukrainën me municione të tilla.
Mbi 120 shtete kanë nënshkruar një traktat ndërkombëtar që ndalon përdorimin e municioneve thërrmuese. Këto municione janë raketa dhe bomba që shpërthejnë në ajër mbi një objektiv dhe lëshojnë shumë pajisje të vogla shpërthyese.
Rusia, Ukraina dhe ShBA-ja nuk e kanë nënshkruar këtë traktat.
Një zyrtar i lartë në Pentagon tha javën e kaluar se municionet thërrmuese mund të jenë të dobishme për Ukrainën në përpjekjet e saj për t'i larguar nga territori forcat ruse. Megjithatë, ky zyrtar tha se vendimi për furnizimin e Kievit me municione të tilla nuk është miratuar ende për shkak të kufizimeve që ka vendosur Kongresi dhe për shkak të shqetësimeve të shprehura nga aleatët.
Ukraina ka përdorur municione thërrmuese në territorin e kontrolluar nga rusët në dhe përreth qytetit ukrainas të Izjumit, që gjendet në lindje, vitin e kaluar, pasi Rusia nisi pushtimin e fqinjit të saj, tha HRW. Kjo organizatë tha se ky konstatim mbështetet në intervistat me mbi 100 banorë, dëshmitarë dhe personelin lokal të emergjencave.
Nga sulmet ukrainase janë vrarë të paktën tetë civilë dhe janë plagosur edhe 15 të tjerë në Izjum, tha HRW.
Kjo organizatë paraprakisht kishte raportuar se Rusia kishte përdorur municione thërrmuese në Ukrainë, që kishin shkaktuar vdekjen e shumë civilëve. Po ashtu, Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara ka dokumentuar përdorimin e municioneve të tilla nga të dyja palët. "Municionet thërrmuese të përdorura nga Rusia dhe Ukraina po vrasin civilët tani dhe do të vazhdojnë t'i vrasin edhe për shumë vite të tëra", tha Mary Wareham, drejtoreshë për armët në HRW. "Të dyja palët duhet që menjëherë të ndalojnë së përdoruri municione të tilla dhe të mos tentojnë të furnizohen me armë të tilla", tha ajo përmes një deklarate.
Qeveria ukrainase i ka bërë thirrje Kongresit amerikan që t'i kërkojë administratës së presidentit Joe Biden ta miratojë dërgimin e bombave thërrmuese.



# Italia dhe Polonia thonë se BE-ja duhet të fokusohet në ndalimin e migrimit

Romë, 6 korrik - Kryeministrat e Italisë dhe Polonisë thanë se Bashkimi Evropian duhet t'u japë përparësi përpjekjeve për ta ndaluar migrimin e paligjshëm në vend që të fokusohet në bindjen e vendeve anëtare për ta ndarë përgjegjësinë për ardhjet e paautorizuara.
Kryeministrja Georgia Meloni, liderja e krahut të djathtë të Italisë, vizitoi Varshavën për t'u takuar me homologun e saj konservator polak, kryeministrin Mateusz Morawiecki.
Italia, duke qenë një nga destinacionet e para për azilkërkuesit që kalojnë Detin Mesdhe për të arritur në Evropë, kërkon ta zvogëlojë numrin e mbërritjeve të tyre.



Javën e kaluar Polonia dhe Hungaria vendosën veton ndaj një deklarate të liderëve të BE-së në lidhje me prioritetet për kufizimin e ardhjeve të emigrantëve në Bashkimin Evropian.
Për më tepër, të dy vendet votuan kundër një marrëveshjeje më 8 qershor që synonte të vendoste një ekuilibër midis detyrimeve të vendeve të vijës së parë dhe kërkesës që vendet e tjera anëtare të ofrojnë mbështetje.
Qeveritë në Varshavë dhe Budapest këmbëngulin se parandalimi i hyrjes së njerëzve në BE është një qasje më e mirë.
Pas bisedimeve të saj me Morawieckin, Meloni tha se ajo mendon se blloku nuk do të jetë në gjendje të "gjejë një zgjidhje reale" për situatën me emigrantë. "Unë besoj se qëndrimi ynë është në thelb i njëjtë. Ne duam ta ndalojmë migrimin e paligjshëm", tha Meloni. Duke iu referuar qëndrimit të qeverisë polake, ajo shtoi: "Unë nuk mund të mos mbroj dikë që mbron interesat kombëtare".
Morawiecki tha se ishte "themelore" për qeverinë e tij që të "izolohen" kufijtë e jashtëm të BE-së dhe se qeveria gjithashtu kundërshtoi një dispozitë në marrëveshjen e qershorit që kërkon gjobitjen e vendeve që refuzojnë të presin një pjesë të azilkërkuesve me 20 000 euro për person.
Polonia ka pranuar miliona refugjatë lufte nga Ukraina, rreth 1.2 milion prej të cilëve janë regjistruar dhe kanë marrë të drejtën për të jetuar, punuar, ndjekur shkollën dhe për të marrë përfitime sociale.
Morawiecki tha se qeveria e tij do të organizojë një referendum këtë vit duke kërkuar nga polakët mendimin e tyre për pranimin e emigrantëve që kanë hyrë ilegalisht në BE.
Të dy krerët folën gjithashtu në një takim të Grupit të Konservatorëve dhe Reformistëve Evropianë, një aleancë e Parlamentit të BE-së.

## Lukashenka thotë se Prigozhini është kthyer në Rusi

Moskë, 6 korrik - Lideri bjellorus Alyaksandr Lukashenka tha se shefi i grupit mercenar rus, Wagner, Yevgeny Prigozhin, më nuk gjendet në Bjellorusi.
Lukashenka kishte ndërmjetësuar një marrëveshje që i dha fund rebelimit të armatosur në Rusi më 24 qershor. Tri ditë më vonë, lideri bjellorus tha se Prigozhin gjendej në Bjellorusi.
Mercenarët e Wagnerit për një kohë të shkurtër morën kontrollin e qytetit rus, Rostov-mbi-Don, më pas marshuan drejt Moskës. Por, ata u ndalën pak para se të arrinin në kryeqytetin rus, pas marrëveshjes së ndërmjetësuar nga Lukashenka.
Presidenti rus, Vladimir Putin, ka deklaruar se mercenarët e Wagnerit, që nuk morën pjesë në rebelim, mund të shkojnë në Bjellorusi ose t'i bashkohen ushtrisë së rregullt ruse.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA VIZITUAR KOSOVËN

# KURTI IA MBYLLI DERËN RAMËS

Nuk mbahet mend që prej pasluftës që një kryeministër i Kosovës t'ia ketë mbyllur derën kryeministrit të Shqipërisë, presidentit apo kryeparlamentarit të këtij vendi kur kanë parashtruar kërkesë për vizitë në Prishtinë, pavarësisht qoftë edhe bindjeve politike. Por këtë e ka bërë të enjten kryeministri Albin Kurti, duke mos pranuar takim me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Ky i fundit gjatë turneut të tij në kryeqytetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor, në Prishtinë u prit nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryeparlamentari Glauk Konjufca, ku u theksua nevoja e forcimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve të dy shteteve



Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë turneut të tij në kryeqytetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor, në Prishtinë është pritur të enjten nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

Presidentja, pas takimit, tha se me Ramën diskutuan "proceset e ardhshme në agjendën ndërkombëtare, me fokus në Samitin e NATO-s dhe Samitin e Procesit të Berlinit".

Turneu ballkanik i Ramës synon pikërisht të informojë shtetet e rajonit për përgatitjet që po bën Shqipëria për të pritur samitin e Procesit të Berlinit. "U bisedua për domosdoshmërinë e hyrjes në fuqi të të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani në këtë proces [të Berlinit], e sidomos asaj që ka të bëjë me lirinë e lëvizjes, si dhe për mundësinë e rritjes së projekteve dhe fondeve përfituese për vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit", tha Presidenca e Kosovës përmes një njoftimi për media.

Në këtë takim dypalësh u tha se u diskutua gjithashtu për situatën e sigurisë në veri të Kosovës, dhe se presidentja Osmani theksoi se Kosova "ka demonstruar vullnet për deeskalim, duke ofruar organizimin e zgjedhjeve të reja në veri të vendit, në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës".

Mes tjerash, sipas njoftimit të Presidencës, thuhet se Rama dhe Osmani u dakorduan që "të vazhdojnë koordinimin në të mirë të qytetarëve" të Kosovës dhe Shqipërisë. "Forcimi i mëtejmë i bashkëpunimit në mes të dy shteteve tona është në të mirë të qytetarëve tanë dhe në të mirë të së ardhmes sonë të përbashkët euroatlantike", ka shkruar presidentja Osmani në "Facebook".

Rama, më herët gjatë ditës së enjten njoftoi se Kosovës i janë dërguar 13 marrëveshjet të nënshkruara dhe pas kësaj, ai pret që homologu i tij nga Kosova, Albin Kurti, të konfirmojë takimin e paraparë të mbahet më vonë gjatë ditës.

Rama iu referua 13 marrëveshjeve që do të duhej të nënshkruheshin gjatë mbledhjes së dy qeverive në Gjakovë më 14 qershor, por që u anulua nga Rama për shkak të tensioneve në veri të Kosovës. "Mbetem me shpresë se pas heqjes së merakut të shprehur publikisht nga kryeministri Kurti për qytetarët e penguar të përfitojnë nga 13 marrëveshjet, do të kemi edhe konfirmimin e takimit me Albinin sot pasdite", ka shkruar Rama në "Twitter".

Megjithatë, deri të enjten mbrëma, një takim mes dy kryeministrave nuk u zhvillua.

Rama ka takuar edhe kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca.

Ai ka bërë me dije se me Konjufcën ka pasur një bisedë miqësore, të hapur dhe interesante.

Kryeministri Rama paraqiti pikëpamjen e tij mbi pozicionin që Kosova sot ka kundrejt aleatëve të saj.

Kryetari Konjufca shprehu bindjen se roli i Shqipërisë mund të jetë shumë ndihmues në kuptimin e pozicionit të Kosovës, e cila është në të drejtën e saj kur insiston në zbatimin e shtetit ligjor dhe funksionalizimit të demokracisë në krejt territorin e Kosovës.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan që situata është shqetësuese dhe se sa më parë duhet të shkohet drejt një zgjidhjeje që do mundësonte zhvillimin e zgjedhjeve në komunat veriore dhe kthimin e serbëve në institucione përmes proceseve dhe procedurave demokratike.

Kryetari Konjufca theksoi nevojën që bashkësia ndërkombëtare të ushtrojë presion mbi Serbinë që marrëveshja e Ohrit të zbatohet në plotni dhe raportet mes Kosovës dhe Serbisë të futen në shtegun e normalizimit si dy subjekte shtetërore sovrane dhe respektuese ndaj njëra-tjetrës. Për kryetarin Konjufca mbështetja e Shqipërisë ndaj Kosovës është gjithnjë e nevojshme dhe e çmuar dhe Kosova gjithmonë është më e fuqishme kur e ka Shqipërinë në krah.

Ndërkaq në një deklarim për medie pas takimit me Ramën, Konjufca tha se raportet Ram-Kurti janë të lënduara.

Partitë opozitare në Kosovë kanë reaguar lidhur me mostakimin mes Kurtit dhe Ramës.

Deputeti i subjektit më të madh opozitar, Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, tha se me vendimin për të mos e takuar Ramën, kryeministri Kurti ka shfaqur "hipokrizi politike". "Hipokrizia politike e Albin Kurtit shpërfaqet në sjelljen e tij si të një feudali mesjetar dhe autokrati inatçor, që deri sa ishte në opozitë fliste për bashkim kombëtar me Shqipërinë dhe sot nuk mund të bashkohet në takim me Kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama", ka shkruar Hoxhaj në "Twitter".

Ndërkaq, shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në opozitë, Besnik Tahiri, ka kërkuar që Kurti të takohet me Ramën dhe të mos vë kushte për takime të tilla.

Sipas agjendës së publikuar, Rama të enjten ka qëndruar në Shkup, ku është takuar me krerët shtetërorë atje. Pas Prishtinës, ai të premten do të vizitojë Bosnje e Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë.

## Rama: Të gjitha qeveritë e tjera janë i përgjigjur kërkesës sonë, kjo e Kurtit jo

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama në një intervistë dhënë të enjtën në mbërmje në Rubikon në Klan Kosova, ka thënë se ende s'ka asnjë përgjigje zyrtare nga Qeveria e Kosovës se a do të mbahet takimi me kryeministrin Kurti apo jo.

Ai tha se edhe në momentet sa po jepet intervista, kabineti i Qeverisë së Kosovës nuk i është përgjigjur kabinetit të Qeverisë së Shqipërisë. "Por mua më shqetëson fakti që edhe tani që flasim, ne ende s'e kemi marrë një përgjigje zyrtare e serioze nga një shtet serioz që ia kërkon zyrtarisht dhe të përgjigjet zyrtarisht. Nuk kemi asnjë përgjigje sepse s'kemi pasur mundësi të kemi përgjigje zyrtare. Të gjitha qeveritë e tjera janë përgjigjur siç e kemi bërë ne kërkesën. Edhe tani që flasim s'ka qenë e mundur të kontaktohet kabineti", tha Rama.

Tutje, ai foli edhe për Kanunin, ku e përdori si shprehje gjatë një interviste në Maqedoni të Veriut të enjten. "Edhe ajo e kanunit nuk është pa vlerë, sepse është bazë e traditës tonë. Ne krenohemi gjithandej që 'shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut'. Dhe kur thuhet 'miku', nuk thuhet vetëm miku që ti fton, por ai që troket në derë, të cilin ti mund mos ta njohësh ose edhe hasmi yt. Dhe ti je i detyruar ta hapësh derën dhe ta presësh, pavarësisht se është një prani që t'i nuk e dëshiron dhe në këtë sens, edhe kaq mjafton për të mos krijuar shfaqje të tilla", tha Rama.

Më tej, Rama tha se Kurtit i ka bërë aq shumë kërkesa për takimin e së e enjtes sa "as në rininë time s'i kam shkuar mbrapa një Xhuljete indiferente me aq shumë kërkesa".

## Shqipëria i firmos 13 marrëveshjet me Kosovën

PRISHTINË, 6 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije të enjten në mëngjes, para vizitës në Prishtinë, se janë dorëzuar në Ministrinë e Jashtme në Kosovë të 13 marrëveshjet e mbledhjes së dy qeverive të firmosura nga ana e Shqipërisë.

Rama ka thënë se mbetet me shpresë se pas kësaj do të ketë takim me kryeministrin Kurti. "Me kundërfirmosjen e palës kosovare ato hyjnë menjëherë në fuqi. Mbetem me shpresë se pas heqjes së merakut të shprehur publikisht nga KM Kurti për qytetarët e penguar të përfitojnë nga 13 marrëveshjet, do të kemi edhe konfirmimin e takimit me Albinin sot pasdite", ka shkruar Rama në "Facebook".





# Gjermania ndërpret bashkëpunimin me Kosovën në disa fusha shkaku i tensioneve

Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë ka ndërprerë përkohësisht bashkëpunimin me Kosovën në disa fusha të caktuara shkaku i mospërmbushjes së kërkesave të Bashkimit Evropian për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Masat përfshijnë shtyrjen e konsultimeve qeveritare për bashkëpunimin për zhvillim, pezullimin e një partneriteti të parashikuar dypalësh rreth klimës dhe dorëzimin e pajisjeve specifike për ofruesit e sigurisë

**Prishtinë, 6 korrik** - Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se ka ndërprerë përkohësisht bashkëpunimin me Kosovën në disa fusha të caktuara shkaku i mospërmbushjes së kërkesave të Bashkimit Evropian për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.

Nga kjo masë - të cilën Gjermania thotë se e mori në përputhje me veprimet e Brukselit - nuk preken "projektet me sektorin e shoqërisë civile, si dhe projektet që kemi filluar t'i zbatojmë". "Masat përfshijnë shtyrjen e konsultimeve qeveritare për bashkëpunimin për zhvillim, pezullimin e një partneriteti të parashikuar dypalësh rreth klimës dhe dorëzimin e pajisjeve specifike për ofruesit e sigurisë", thuhet në përgjigjen e Ambasadës së Gjermanisë për REL-in.

Në fund të muajit qershor, BE-ja njoftoi se kishte vendosur disa masa të përkohshme ndëshkuese ndaj Kosovës, pasi që qeveria e vendit nuk ndërmori hapat e kërkuar nga blloku evropian për shtensionim të situatës në veri.

Në atë pjesë të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, tensionet janë të larta që nga fundi i majit, kur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave hynë në zyrat e tyre, me gjithë rezistencën dhe protestimin e banorëve serbë.

Protestat e tyre u përshkallëzuan edhe në përleshje të dhunshme, me dhjetëra të plagosur - në mesin e të cilëve edhe ushtarë të misionit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR.

Kosova ende nuk ka ndërmarrë ndonjë hap pavarësisht prej thirrjeve nga komuniteti ndërkombëtar që t'i tërheqë kryetarët shqiptarë dhe të organizojë zgjedhje të reja.

BE-ja pezulloi përkohësisht punën e të gjitha grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) - që është hapi i parë drejt anëtarësimit në bllok - si dhe ftesat për pjesëmarrjen e Kosovës në takime të nivelit të lartë.

Si BE-ja, ashtu edhe Gjermania, kanë theksuar se këto masa janë të përkohshme dhe mund të hiqen nëse Kosova ndërmerr hapat e kërkuar për shtensionim të situatës. "Ne dëshirojmë të theksojmë se të gjitha projektet e prekura [nga këto masa] mund të rifillojnë në çdo moment. Për këtë kërkohet zbatimi urgjent i masave të nevojshme për shpërshkallëzim të situatës në komunat në veri", thuhet në përgjigjen e Ambasadës së Gjermanisë.

Kosova ka mbetur edhe jashtë granteve që Bashkimi Evropian ka miratuar për projektet në kuadër të Kornizës për Investime në Ballkanin Perëndimor.

Nga këto investime përfituan Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina, përkatësisht Federata boshnjako-kroate.

Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor është një iniciativë e përbashkët e BE-së, institucioneve financiare dhe donatorëve, që synon zhvillimin socio-ekonomik dhe të perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Vlera e përgjithshme e kornizës është 2.1 miliardë euro.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka quajtur masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian "të padrejta" dhe ka thënë se shpreson që ato të jenë të shkurtra pasi që "Kosova është një vend që ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e saj".

Kurti tha se ai do ta vazhdojë programin qeverisës, pasi shtoi se "nuk mund të bëj kompromis as me sundimin e ligjit e as me kushtetutshmërinë e vendit".

"Pra, këto nuk janë sanksione. Por, është e vërtetë që janë masa të përkohshme, por të padrejta për shkak se Kosova dhe Qeveria e saj janë edhe shteti, edhe ekzekutivi më demokratik, pro-evropian dhe progresist", tha Kurti.

Ai shtoi se "shpresojmë që këto masa të përkohshme do të jenë fort të shkurtra ashtu që edhe mbështetja edhe ndihma evropiane të jenë të plota, mbase edhe të rriten".

Partitë opozitare, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, kanë reaguar ndaj

# Zyrtari i NATO-s: Prishtina dhe Beogradi të ndërmarrin hapa për shtensionim

Prishtinë, 6 korrik - Ndihmëssekretari i përgjithshëm i NATO-s për operacionet, Tom Goffus, gjatë vizitës së tij në Kosovë, ka thënë se “është urgjente që si Prishtina ashtu edhe Beogradi të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për shërshkallëzim” dhe se “zgjidhja për stabilitet të qëndrueshëm është një zgjidhje politike”. “Është thelbësore që të dyja palët t’i koordinojnë siç duhet veprimet në terren dhe t’i respektojnë marrëveshjet ekzistuese”, tha ai.

Ai u ka bërë thirrje të dyja palëve që të angazhohen në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe që sa më shpejt ta zbatojnë Marrëveshjen e Ohrit.

Gjatë vizitës së tij në Kosovë, Goffus është takuar me presidenten e Kosovës Vjosa Osmani dhe kryeministrin e vendit Albin Kurti.

Në takimin e Kurtit me Goffus, Qeveria e Kosovës tha se kryeministri ka ngritur shqetësimin “për mungesën e ofrimit të qartësisë nga KFOR-i” sa i përket arrestimit të tre policëve të Kosovës më 14 qershor “përkundër evidencës së bollshme të ofruar nga institucionet e Kosovës”.

Autoritetet e Kosovës kanë thënë vazhdimisht se policët janë rrëmbyer brenda territorit të vendit, ndërsa ato në Serbi kanë thënë se ata kanë qenë “thellë” në territorin e tyre kur janë arrestuar.

Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, më 16 qershor kishte thënë se nuk është e qartë se ku kanë qenë tre policët e Kosovës në kohën e arrestimit nga forcat serbe. “Pas arrestimit të tre zyrtarëve të Policisë së Kosovës më 14 qershor, misioni i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO-ja, ka rishikuar vendndodhjen e ngjarjes dhe ka folur me përfaqësues të institucioneve në Kosovë dhe me autoritetet serbe. Bazuar në të dhënat e disponueshme, mbetet e paqartë se ku kanë qenë zyrtarët e Policisë së Kosovës në momentin e arrestimit”, thuhej në komunikatën e KFOR-it.

Sipas njoftimit të qeverisë, kryeministri ngriti edhe shqetësimin për raportimet se në kishat ortodokse serbe është kontrabanduar armatim përmes ambulancave.

Pretendimet në lidhje me kontrabandën e armëve përmes autoambulancave dhe ruajtjen e tyre nëpër kisha në Kosovë i bëri publike një ditë më parë ligjvënësja britanike Alicia Kearns gjatë një debati në Parlamentin britanik.

Ligjvënësja britanike Kearns tha se ushtarët britanikë, që janë në kuadër të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, “zbuluan se armët po kontrabandoheshin përmes kufirit nga Serbia në kishat ortodokse në Kosovë, duke përdorur autoambulanca”.

Misioni i KFOR-it tha se ngjarjet që janë përmendur nga deputetja britanike i referohen vitit 2022 kur “një batalion i ushtrisë britanike ishte angazhuar në veri të Kosovës në mbështetje të misionit të NATO-s”.

Ky mision tha se për praninë e pretenduar të armëve të paligjshme është raportuar në shtabin e KFOR-it, por gjatë hetimeve të kryera nuk janë gjetur prova për kontrabandë.

Gjatë takimit me zyrtarin e lartë të NATO-s, kryeministri Kurti gjithashtu thuhet se ka përmendur masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian të vendosura ndaj Kosovës, duke thënë se ato kanë krijuar asimetri në dialog. “Sundimi i ligjit, mungesa e protestave të dhunshme e aktiviteteve kriminale dhe zgjedhjet e hershme janë rruga përpara drejt de-eskalimit dhe për këtë qeveria është maksimalisht e angazhuar”, thuhet në njoftimin për medie nga Kryeministria.



### Goffus takohet me Osmanin

Ndihmëssekretari i përgjithshëm në NATO-s për operacione u prit në takim edhe nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Në njoftimin për medie nga Presidenca e Kosovës u tha se me Goffus, Osmani diskutoi për situatën e sigurisë në veri të vendit dhe hapat për shtensionimin e gjendjes në këtë pjesë të vendit.

Presidentja Osmani ka theksuar në këtë takim se institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që së bashku me partnerët ndërkombëtarë t’i tejkalojnë sfidat aktuale dhe fuqizimin e sundimit të ligjit.

“Po ashtu, ajo theksoi se Kosova ka demonstruar vullnet për deeskalim, duke ofruar organizimin e zgjedhjeve të reja në veri të vendit në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës”, thuhet në njoftim.

Gjithashtu, Osmani citohet të ketë thënë se institucionet e Kosovës mbeten “të përkushtuara ndaj përgjegjësive [që i kanë] si një partner i besueshëm i NATO-s, duke kontribuar aktivisht në sigurinë rajonale”.

Vizita e Goffus në Kosovë vjen në kohën kur tensionet në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, janë të larta dhe bashkësia ndërkombëtare po bën thirrje të vazhdueshme për shtensionim të kësaj situate.

Që nga fundi i majit serbët po protestojnë në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, duke kundërshtuar që kryetarët e rinj shqiptarë të punojnë nga ndërtesat komunale. Banorët lokalë serbë, po ashtu, po kërkojnë tërheqjen e njësive speciale të Policisë së Kosovës nga afërsia e ndërtesave.

Serbët lokalë janë përleshur me pjesëtarët e KFOR-it në Zveçan më 29 maj. Nga përleshjet janë plagosur dhjetëra persona nga të dyja palët.

Bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia të ndërmarrin hapa për uljen e menjëhershme të tensioneve dhe në veri të mbahen zgjedhje të reja lokale.

## Vuçiqi thotë se do të kërkojë seancë për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së



Prishtinë, 6 korrik - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë të enjten se do të kërkojë një bisedë me shefin e NATO-s, Jens Stoltenberg dhe, pas saj, një seancë urgjente të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB) për shkak të situatës në Kosovë. Ai ka thënë se do të kërkojë që Këshilli i Sigurimit ta urdhërojë KFOR-in që, bazuar në detyrimet e Rezolutës 12 44, të parandalojë çdo veprim të mëtejshëm nga strukturat e sigurisë së Kosovës, që “kërcënon jetën, lirinë, sigurinë dhe mbijetesën e serbëve në Kosovë”, për ta kryer “çmilitarizimin e të gjitha formacioneve të armatosura”.

Vuçiqi tha se Serbia bëri gjithçka që mundi për ta shtensionuar situatën në Kosovë, por se në Kosovë po kryhet një “aksion i pogromit, persekutimit dhe spastrimit etnik” të serbëve, i cili është “mirë i organizuar dhe i mbështetur nga një pjesë e komunitetit ndërkombëtar”.

Sipas tij, në Kosovë po bëhet “kriminalizimi i popullit serb”.

masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian për Kosovën. Sipas opozitës, Kosova është në një pozicion të keq ndërkombëtarisht.

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka theksuar se sot Kosova është e përçarë nga brenda dhe e sanksionuar nga aleatët.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Kosova u pezullua në katër aspekte. “Pezullim i fondeve të BE-së, pezullim i MSA-së, pezullim i takimeve të nivelit të lartë, pezullim i vizitave bilaterale. Sanksione Kosovës, avancim për Serbinë. Si qenka kjo fitore për ne? Teksa ne përjashtohemi nga programet ushtarake me NATO-n, Serbia vazhdon misionet paqeruajtëse me ta. Teksa ne humbasim nga programi 7.5 miliardësh për zhvillim digjital, shtetet e rajonit ecin me hapa të mëdhenj. Kam takuar në vazhdimësi biznese nga komuniteti i IT-së, punëdhënës të jashtëzakonshëm, me potencial dhe më të madh. Sot humbasin ata dhe të rinjtë që do të punësonin në vazhdimësi”, ka shkruar Abdixhiku.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se duke qenë i vetëdijshëm se Kosova me këtë kryeministër po hyn në një rrugë pa krye, para pak ditësh ka kërkuar mocion për shkarkimin e Albin Kurtit. “Sanksionet e BE-së ndaj Kosovës dhe paralajmërimet e ShBA-së se Qeveria e Kosovës është në rrugë të gabuar, e dëshmojnë se sa e rrezikshme dhe e pashpresë është gjendja, e cila, fatkeqësisht, do të shkojë duke u përkeqësuar gjithnjë e më shumë”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

## Përfunduan intervenimet në tri shtigje të gjelbra në Prizren

**Prizren, 6 korrik** - UNDP-ja përmes projektit "Fuqizimi i veprimit lokal për klimën" ka përfunduar intervenimet në tri shtigje të gjelbra - në tri lokacione të ndryshme në Prizren.
Kryetari i komunës, Shaqir Totaj, ka thënë se janë vendosur konstruksione për mbajtjen e bimëve dhe janë mbjellë bimë të llojit "Hedera Helix", të cilat së shpejti do të krijojnë kurora natyrale dhe hijezim në këto shtigje. "Vazhdojmë përkushtimin tonë për kujdesin ndaj hapësirave të gjelbra, që janë të shumta në komunën e Prizrenit", k shkruar Totaj në "Facebook".




# Dhoma e Tregtisë nënshkruan memorandum bashkëpunimi me komunën e Lipjanit

**Lipjan, 6 korrik** - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me komunën e Lipjanit përmes të cilit pajtohen të krijojnë partneritet të qëndrueshëm me qëllim të shkëmbimit dhe ofrimit të këshillave profesionale për bizneset dhe nga vetë bizneset, në fusha të ndryshme, si dhe asistimit, promovimit dhe përkrahjes së bizneseve.
Nënkryetari i Dhomës së Tregtisë, Arsim Selmonmusaj, ka thënë se bizneset që DHTIK-ja përfaqëson mirëpresin bashkëpunimin me komunën e Lipjanit, gjithashtu shprehu gatishmërinë e Dhomës për promovim të ofertave përkrahëse për zhvillim të bizneseve në komunën e Lipjanit.
Ndërsa drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim në komunën e Lipjanit, Valon G. Pacolli, ka falënderuar Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, duke theksuar se përmes memorandumit do të thellohet bashkëpunimi ndërmjet dy palëve dhe së bashku do të trajtohen edhe barrierat që hasin bizneset në nivele më të larta, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Lipjan.
Pacolli ka theksuar se prioritet i komunës mbetet zhvillimi ekonomik. "Prandaj në vazhdimësi mbështesin bizneset dhe për këtë kanë ndarë edhe Zonën Ekonomike në fshatin Qylagë të komunës së Lipjanit", ka thënë Pacolli.




# QKMF-ja në Podujevë furnizohet me dy aparatura të reja, vertebrogramin dhe rëntgenin mobil



**Podujevë, 6 korrik** - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtoreshën e Shëndetësisë, Adelina Stublla, ushtruesin e drejtorit të QKMF-së, Bajram Bajgora, dhe stafin shëndetësor të QKMF-së, kanë vizituar hapësirat e radiologjisë dhe emergjencës, aty ku janë vendosur dy aparaturat e reja vertebrogrami dhe rëntgeni mobil.
Vertebrogrami është aparaturë radiologjike për fotografimin e gjithë boshtit kurrizor. Kjo aparaturë shërben për zbulimin e hershëm të deformimeve të boshtit kurrizor skoliozës patologjike dhe patologjive të tjera.
Rëntgeni mobil është aparat i lëvizshëm përmes të cilit fotografohet çdo pjesë trupi, do të shfrytëzohet për rastet e rënda të emergjencës dhe rastet shtëpiake të palëvizshme me indikacion të domosdoshëm për fotografim.
Kryetari Bulliqi ka thënë se angazhimi si qeverisje komunale është të përmirësohen shërbimet shëndetësore për pacientët në QKMF dhe në qendrat e tjera.



# Komuna e Rahovecit formon Shtabin Komunal për Korrje-shirje për vitin 2023

**Rahovec, 6 korrik** - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar vendimin për caktimin e Shtabit Komunal për Korrje-shirje për vitin 2023. Shtabi Komunal ka për detyrë të bëjë përcjelljen e korrje-shirjeve në terren, në gjithë territorin e komunës së Rahovecit, gjatë tërë fushatës deri në përfundim të saj. Pika tre e vendimit e obligon shtabin komunal që me kohë ta njoftojë kryetarin e komunës si dhe personat e tjerë kompetentë nga sfera e bujqësisë si dhe Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me raporte kohë pas kohe lidhur me rrjedhën e korrje-shirjeve.

## Treni godet një veturë në Klinë, vdes një person

**Klinë, 6 korrik** - Të enjten rreth orës 12:45 treni ka goditur një veturë në fshatin Videjë të Klinës. Për pasojë, një person ka humbur jetën. Lajmin e ka bërë me dije Policia e Kosovës përmes një komunikate për medie. "Policia menjëherë ka dalë në vendngjarje. Aty është kuptuar që si pasojë e aksidentit një person (vozitësi i veturës) është lënduar rëndë. Ai është dërguar në emergjencën e spitalit rajonal në Pejë. Ekipi mjekësor ka konstatuar vdekjen e viktimës", thuhet në komunikatë.
Me urdhër të prokurorit të shtetit trupi i viktimës dërgohet në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë për obduksion.



# BE-ja: Shpallja e dy organizatave në veri terroriste, hap i njëanshëm



**Prishtinë, 6 korrik** - Bashkimi Evropian tha për Radion Evropa e Lirë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për t'i shpallur "Mbrojtjen Civile" dhe "Brigadën e Veriut" organizata terroriste është "hap i njëanshëm" që, sipas bllokut, nuk i kontribuon uljes së tensioneve.

Qeveria e Kosovës më 29 qershor i shpalli këto dy organizata si terroriste. Ato besohet se veprojnë në veriun e Kosovës dhe numërojnë qindra pjesëtarë nga radhët e komunitetit serb, që janë shumicë në këtë zonë. "Ky cilësim [shpallja si organizata terroriste] është hap i njëanshëm dhe nuk i kontribuon shtensionimit të situatës dhe gjetjes së rrugës për të adresuar problemet ekzistuese në një mënyrë të qëndrueshme", tha zëdhënësi i bllokut evropian, Peter Stano, në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë.

Stano shtoi se liderët e 27 shteteve anëtare të BE-së gjatë një takimi të mbajtur javën e kaluar bënë thirrje për shtensionim të menjëhershëm të situatës në veri të Kosovës. "Ne përsërisim thirrjen për të dyja palët që të përmbahen nga çdo veprim apo retorikë që mund të çojë në rritjen e mëtejme të tensioneve dhe që urgjentisht të ndërmarrin hapa për të shtensionuar situatën aktuale në veri të Kosovës në linjë me propozimin e bërë nga përfaqësuesi i lartë, Josep Borrell, më 22 qershor dhe deklaratës së BE-së të 3 qershorit", tha Stano.

Edhe Departamenti amerikan i Shtetit i ka thënë më herët Radios Evropa e Lirë se Kosova nuk është koordinuar me ta e as me partnerët e tjerë perëndimorë lidhur me vendimin e ndërmarrë për "Mbrojtjen Civile" dhe "Brigadën e Veriut".

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka argumentuar se "Mbrojtja Civile" dhe "Brigada e Veriut" paraqesin "kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për rendin kushtetues dhe sigurinë në Kosovë". Sipas tij, këto dy organizata kanë kryer veprime "me elemente terroriste", si: sulme të armatosura ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, pjesëtarëve të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX dhe ushtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Autoritetet në Kosovë kanë sqaruar se vendimi për shpalljen e këtyre dy organizatave terroriste nuk do të prekë askënd që mund të ketë kryer vepra penale para këtij vendimi. Sipas ligjit në Kosovë, kur organizatat shpallen terroriste, aktiviteti i tyre ndalohet menjëherë. Çdo aktivitet i mëtejmë i tyre do të bartte pasoja të rënda ligjore.

Që nga përfundimi i luftës më 1999 në Kosovë operojnë struktura ilegale, të mbështetura dhe financuara nga shteti i Serbisë.

Një ndër to është edhe "Mbrojtja Civile", e cila ka dalë publikisht më 2011. "Mbrojtja Civile" në Serbi funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe roli i saj është të reagojë në situata emergjente të rrezikut, siç janë përmbytjet, tërmetet e të ngjashme.

Shuarja e saj është paraparë në marrëveshjen e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë më 2015 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Ndërkaq, në gusht të vitit 2022, në pjesën veriore të Kosovës, u shfaqën grafite me një logo dhe mbishkrimin "Brigada e Veriut" në serbisht.

Përveç grafiteve me logo të saj në disa rrugë dhe objekte të ndryshme në pjesën veriore të Kosovës nuk dihet se kush qëndron pas saj, nëse ka anëtarë aktivë dhe cili është roli i tyre.

Shpallja e "Mbrojtjes Civile" dhe "Brigadës së Veriut" si organizata terroriste vjen në kohën kur tensionet në veri të Kosovës janë rritur.

Që nga fundi i majit serbët në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok po kundërshtojnë që kryetarët e rinj shqiptarë të punojnë nga ndërtesat komunale. Ata, po ashtu, po kërkojnë tërheqjen e njësive speciale të Policisë së Kosovës nga veriu.

Që nga ajo kohë në veri janë shënuar disa incidente me shok-bomba dhe granata dore si dhe më 29 maj në Zveçan protestuesit serbë janë përleshur me pjesëtarët e KFOR-it. Nga këto përleshje kanë mbetur të lënduar dhjetëra persona nga të dyja palët.

Bashkësia ndërkombëtare i ka kërkuar Kosovës dhe Serbisë të ndërmarrin hapa të menjëhershëm që të ulen tensionet në veri. Kosovës po i kërkohet të organizojë zgjedhje të reja në katër komunat veriore, ndërkaq Serbisë t'i bindë serbët që të marrin pjesë në procesin zgjedhor.

## Haradinaj përkujton nëntë dëshmorë

**Prishtinë, 6 korrik** - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se para 25 vjetëve Loxha heroike u përball me armikun, duke shënuar një kapitull të lavdishëm të luftës sonë për liri. "Sot kujtojmë trimat e UÇK-së dhe ata që u përjetësuan: Tahir Shala, Rrustem Bruqi, Enver Alaj, Lumni Surdulli e Xhavit Qufaj. Po ashtu, kujtojmë luftëtarët nga fshati Rudicë, Nimon Bajraktari, Haki Ahmetxhekaj e Bashkim Mehmetaj, që ranë në rrugën e tyre për t'i sjellë armët e lirisë. Në të njëjtën ditë ra dhe bashkëluftëtari Arsen Mazrekaj. Lavdi e përjetshme të rënëve për liri!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



## Ndryshimi i Ligjit për Skemat Pensionale, reagon BSPK-ja

PRISHTINË, 6 KORRIK - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës ka reaguar në lidhje me plotësim-ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të financuara nga shteti. "Lajmi përkitazi me miratimin e projektligjit për plotësim ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nr. 04/L-131, obligon partnerin tonë social edhe për punë më intensive drejt plotësimin e kërkesave. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës thërret deputetët e Kuvendit të Kosovës që sa më parë ta miratojnë këtë projektligj për t'i hapur rrugë shpalljes së shumëpritur të tij që të mund të fillojë e të zbatohet për të rritur sado pak mirëqenien sociale e ekonomike të qytetarëve që derdhën djersën gjithë andej vendit tonë për të mirën e përbashkët. Kërkesat e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës ishin kërkesa të arsyeshme dhe do të jenë edhe në vazhdim të arsyeshme e të pandalshme", thuhet në reagimin e BSPK-së. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës ka theksuar se pret që sa më parë të caktohet e të miratohet edhe vlera e duhur financiare e pagës minimale e të negociohet vlera e re për vitin 2024, gjithashtu të bëhet nënshkrimi i Kontratës së Përgjithshme Kolektive. "Së bashku me plotësim ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, po edhe me miratimin e Ligjit për Sigurimin Shëndetësor të nisë ndërtimi i mirëqenies së duhur sociale e ekonomike për të punësuarit po edhe për familjet e tyre e njëkohësisht edhe për të gjithë qytetarët", thuhet në reagimin e BPSK-së.




# Gjykata e Pejës merr vendim për lirimin e vilave të sekuestruara në Brezovicë



PEJË, 6 KORRIK - Gjykata Themelore në Pejë ka hedhur poshtë kërkesën e prokurorit Rasim Maloku për caktim të masës së sigurisë për vilat e sekuestruara në tetor të vitit të kaluar në Brezovicë.
Rreth 76 objekte u patën sekuestruar përkohësisht në aksionin për sekuestrimin e objekteve të ndërtuara në Brezovicë në Zonën II të Parkut Kombëtar "Sharri", pasi dyshohej se janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin.
Të njëjtat tashmë janë liruar dhe do t'u kthehen pronarëve.
Lajmin e ka konfirmuar për "Telegraf"-in zëdhënësja e Gjykatës së Pejës, Tringa Zhuti. "E konfirmojmë se me Urdhrin e Gjykatës Themelore në Pejë UGJK, nr. 161/22, të datës 06.07.2023, është hedhur si e pasafatshme kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për masë të përkohshme për sigurimin e pasurisë së sekuestruar. Është marrë vendim për lirimin e tyre dhe të njëjtat do t'u kthehen pronarëve", ka thënë Zhuti.
Sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj, këto objekte janë ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për Parkun Kombëtar "Sharri" si dhe Planin Hapësinor për Pakun Kombëtar "Sharri".
Këto objekte, siç bëhej e ditur nga prokuroria, "janë ndërtuar duke keqpërdorur detyrën zyrtare nga të pandehurit në këtë rast, me lëshimin e lejeve ndërtimore në kundërshtim me ligjet që rregullojnë Parkun Kombëtar 'Sharri', me marrje të ryshfetit, dhënie të ryshfetit, me çka kanë degraduar mjedisin në këtë zonë, kështu që edhe objektet janë rrjedhojë e veprave penale të përshkruara më lart".

## Certifikohen 272 të rinj në shkathtësitë digjitale

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 6 korrik - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka marrë pjesë në ceremoninë e certifikimit të 272 të rinjve të raundit të 6-të të trajnimeve të TIK-ut në kuadër të "ICT for Kosovo's Growth".
Të rinjtë u certifikuan në trajnimet e kryera në Java Programming, Cyber Security, Web Development, Python, Bigdata dhe Machine Learning.
Në total, 1 868 të rinj janë trajnuar dhe 1 513 janë certifikuar, ku 38.3 % e tyre janë vajza. Këta të rinj do të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit tonë të TIK-ut dhe të ekonomisë sonë.
Projekti për trajnimin e të rinjve në shkathtësitë digjitale është ideuar nga Ministria e Ekonomisë dhe është financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programit IPA 2017.
Projekti i certifikimit të të rinjve ka për qëllim t'i plotësojë kërkesat e tregut për fushën e shkathtësisë digjitale dhe biznesore, për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve kosovare digjitale dhe tradicionale dhe për rritjen e eksportit të bizneseve të Kosovës përmes përdorimit të TIK-ut.
Kosova ka mbi 1 500 kompani të TIK-ut dhe më shumë se gjysma e tyre i eksportojnë shërbimet e tyre kryesisht në ShBA dhe BE, dhe këto eksporte janë rritur për 113 % në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.
Në ceremoni, veç ministres Rizvanolli, ka marrë pjesë edhe Johannes Stenbaek nga Zyra e BE-së në Kosovë, Zana Tabaku nga STIKK dhe përfaqësues të fushës së TIK-ut.



# James Cameron, 'Leonardo Da Vinçi' i sotëm

Me filmat "Rambo 2" dhe "Alien", regjosori i "Avatar" e revolucionarizoi mënyrën e kuptimit të vazhdimit të një filmi. Vetëm se Da Vinçi i parë vetëm ka shkruar, i dyti edhe e ka regjistruar. Ndryshimi është aty dhe mund të shihet



E çuditshme për ta thënë sot, por ka pasur një periudhë kur askush nuk priste asgjë nga James Cameron. I lindur në vitin 1954 në Kapuskasing të Kanadasë, James Francis Cameron kishte një ecuri mesatare në shkollë dhe pas përfundimit të gjimnazit punësohet si shofer kamioni.
Kjo deri vitin 1977, kur një ditë shkon në kinema, sheh një nga seritë e filmit "Star Wars" dhe vendos se bota e filmit do të jetë e ardhmja e tij. Katër vite më vonë, ai realizoi një film me një buxhet modest (i paguar me paratë e një shoqate dentare). Me titull "Xenogenesis", ai ishte një film praktikisht amator, por që i bën përshtypje Roger Corman, i cili e dëshiron atë në studion e tij.
Këtu regjisori i ardhshëm i "Avatar" bën pak nga gjithçka: nga asistent/regjisorin tek skenaristi, nga njësia e dytë pas kamerës deri tek skenografia.
Në këtë fazë Cameron dallohet në fusha të ndryshme: është shumë i talentuar në vizatim (si artistik ashtu edhe industrial), ka një sy të mirë, dhe me zgjuarsinë e tij të spikatur është në gjendje të zgjidhë problemet e një filmi, dhe di të shkruajë.
Por ai është totalisht i huaj për Hollywood-in, dhe fati i tij duket të jetë ai i një tekniku prodhimesh me një buxhet të ulët. Nuk është rastësi që u përfshi në drejtimin e efekteve speciale të filmit "Piranhas" (1978) dhe "Piraña Fear" (1982). Për fatin e tij, regjisori i sagës mbi peshkun e rrezikshëm mishngrënës largohet dhe kjo detyrë i caktohet Cameron.
Seria e radhës nuk ishte një prodhim shumë cilësor, por gabimet e regjisorit kanadez ishin deri diku të pashmangshme, si për shkak të kushteve në të cilat ai është i detyruar të punojë, po ashtu edhe për shkak se filmi është shumë i ngatërruar nga producenti.
Karriera e Cameron si regjisor u duk sikur kishte prekur fundin. Por ai kishte një talent si skenarist. Ndaj filloi që të shkruante skenarë. Skenari i tij i parë është një film i vogël fantastiko-shkencor që ngjall interesin e një personazhi të pamundur: Mister Univers, guvernatorit të ardhshëm të Kalifornisë Arnold Schwarzenegger.
Në atë kohë, bodybuilder-i kishte filluar të pëlqehej nga Hollywood-i teksa edhe emri i Cameron nisi të përmendej gjithnjë e më dendur. Kështu, ndërsa nis të marrë formë projekti për filmin "Terminator", James merr disa detyra për shkrimin e skenarit.
Tani duhet kuptuar një gjë: vazhdimi i një filmi në serinë e radhës, është sot pjesë e një diskursi organik të lidhur me zhvillimin e pronësisë intelektuale. Ti krijon një vepër komerciale, me synimin e deklaruar të zgjerimit të saj në një mijë mënyra të ndryshme, gjithmonë nëse kjo gjë është e suksesshme.
Në vitet 1980, vazhdimet e filmave në seri të rja, ishin një ide që u shfaq vetëm më vonë, si një mënyrë e lehtë për të vazhduar vjeljen e përfitimeve të diçkaje që ishte shkuar mirë. Gjithsesi një praktikë e tillë në atë kohë nuk ishte një punë prestigjioze.
